



Stadt Chur

Deutsch für die Schule

**Mësimi i gjermanishtes gjatë vitit para hyrjes
në kopshtin e fëmijëve**

Informacione për prindërit

Janar 2018



Unterstützt durch die Integrationsförderung des Kantons
Graubünden und den Integrationskredit des Bundes (SEM)

Kur një fëmijë arrin moshën pesëvjeçare dhe shkon në kopshtin e fëmijëve (Kindergarten) duhet të jetë në gjendje të komunikojë në gjuhën gjermane. Për fëmijët që nuk kanë njohuri të mjaftueshme të gjuhës gjermane bashkia e ofron një program për mësimin e hershëm të gjuhës. Në vitin para hyrjes në kopsht fëmijët do të shkojnë nga dy gjysmë dite në javë në një institucion gjermano folës së bashku me fëmijët që flasin gjermanisht. Ndërsa prindërit marrin pjesë në një program për edukimin e prindërve dhe e përkrahin fëmijën e tyre në mënyrë aktive gjatë vitit për mësimin e gjuhës gjermane. Çfarë do të thotë kjo për fëmijët, si duhet të veprojnë prindërit dhe me çfarë shpenzimesh duhet të llogaritet? Një përmbledhje.

Përse duhet ta mësojnë fëmijët gjermanishten qysh para se të shkojnë në kopshtin e fëmijëve?

Njohja e gjuhës gjermane është shumë e rëndësishme për të arritur suksese në shkollë. Fëmijët që flasin pak ose nuk flasin fare gjermanisht kur shkojnë në kopshtin e fëmijëve, e fillojnë shkollimin e tyre në kushte më të këqija se shoqet dhe shokët e tyre gjermano folës. Nevojiten disa vjet derisa fëmijët ta zotërojnë gjuhën e vendit – gjermanishten. Për shkak të mosnjohjes së gjuhës gjermane fëmijët shpesh nuk arrijnë rezultate të mira në shkollë. Prandaj është shumë e rëndësishme që ata para se të shkojnë në kopshtin e fëmijëve të mësojnë gjermanisht.

Shkolla e qytetit (Stadtsschule) në Chur ka konstatuar se në të kaluarën më shumë se 20 % e fëmijëve nuk kanë pasur njohuri të mjaftueshme të gjuhës gjermane kur kanë hyrë në kopshtin e fëmijëve. Për këtë arsye në Ligjin për Arsimin të Churit (neni 39) është krijuar mundësia që këta fëmijë të përkrahen dhe që pjesëmarrja e prindërve dhe e fëmijëve të tyre në këtë program të jetë e detyrueshme. Këshilli bashkiak i Churit e ka miratuar në mbledhjen e tij më 8 maj 2014 programin “Deutsch für die Schule”.

Si e mësojnë fëmijët e vegjël gjuhën gjermane?

Fëmijët e vegjël i mësojnë gjuhët përmes kontaktit me personat e afërt në situata të përditshme dhe me bashkëmoshatarët. Shumë ekspertë në grupet e lojërave (Spielgruppen), në çerdhet e fëmijëve (Kinderkrippen) ose në familjet ditore (Tagesfamilien) e kanë përfunduar një trajnim të veçantë dhe e ndihmojnë në mënyrë të posaçme dhe përmes lojës zhvillimin gjuhësor të fëmijëve.

Ekzistojnë edhe shumë arsye tjera përveç mësimin të gjuhës gjermane për ta ndjekur një ofertë të tillë. Në këto institucione fëmijët luajnë bashkë, integrohen në një grup, e zhvillojnë personalitetin e tyre dhe bëhen më të pavarur. Këtu i jepet rëndësi zhvillimit të plotë të fëmijëve.

Si mund ta vlerësoj se a ka fëmija im njohuri të mjaftueshme të gjermanishtes?

Ekspertët e Universitetit të Baselit e kanë zhvilluar nëpërmjet një metode shkencore një pyetësor. Me ndihmën e pyetësorit prindërit mund t'i vlerësojnë saktësisht njohuritë e gjuhës gjermane të fëmijës së tyre, edhe nëse ata vetë nuk e flasin gjermanishten. Pyetësori është në disa gjuhë. Në janar pyetësori do t'ju dërgohet me postë të gjithë prindërve, fëmijët e të cilëve edhe një vit e gjysmë hyjnë në kopsht.

Të gjithë prindërit në Chur, fëmijët e të cilëve kanë lindur në vitin 2014, duhet patjetër ta plotësojnë pyetësorin saktë dhe ta dërgojnë me postë deri më 05.02.2018.

Përgjigjet do të vlerësohen nga Universiteti i Baselit. Prindërit do të informohen me shkrim në muajin mars nga Shërbimi Social i Chur-it (Soziale Dienste Chur) për rezultatin dhe për procedurën e më tutjeshme. Nëse vlerësimi tregon se njohuritë e gjuhës gjermane të një fëmije për pranimin e tij në kopshtin e fëmijëve nuk janë të mjaftueshme, atëherë do të jepet një rekomandim për pjesëmarrje në programin „Deutsch für die Schule“.

Një rekomandim – çfarë pastaj?

Nëse një fëmijë e merr një rekomandim për ta mësuar gjuhën gjermane, atëherë prindërit e tij duhet ta kërkojnë një vend të përshtatshëm në ndonjë institucion parashkollor. Përvoja tregon se shumica e prindërve e dërgojnë fëmijën e tyre në një grup të lojërave (Spielgruppe). Por ekziston mundësia për ta dërguar fëmijën edhe në një çerdhe për fëmijë (Kinderkrippe) apo në një familje ditore (Tagesfamilien). Drejtorja e programit „Deutsch für die Schule“ i ndihmon prindërit për ndërmjetësimin e vendeve të lira.

Nëse prindërit e kanë gjetur një vend të lirë, atëherë së bashku me drejtorin e institucionit parashkollor e plotësojnë një vërtetim dhe ia dërgojnë atë drejtores së programit.

Sa herë duhet të marrë pjesë fëmija im?

Programi i obligon fëmijët ta mësojnë gjuhën gjermane nga dy gjysmë dite në javë gjatë vitit para hyrjes në kopshtin e fëmijëve. Një gjysmë dite në një grup lojërash zgjat të paktën tri orë. Vijimi i rregullt është i detyrueshëm. Vlejnë pushimet shkollore të Bashkisë së Churit. Prindërit pajtohen që institucionet parashkollore do ta informojnë drejtorin e programit në qoftë se fëmija nuk merr pjesë rregullisht në mësim ose nëse prindërit nuk e paguajnë tarifën.

Sa paguajnë prindërit?

Nëse fëmija në kuadër të programit shkon dy herë nga një gjysmë dite në javë në një grup lojërash (Spielgruppe), çerdhe fëmijësh (Kinderkrippe) apo në një familje ditore (Tagesfamilie), Bashkia e Churit merr pjesë në shpenzime në formë të lehtësirave tarifore. Këto janë të kategorizuara sipas të ardhurave dhe pasurisë së tatueshme dhe sillen nga 20 deri 80 % zbritje të tarifave përkatëse.

Kusht për lehtësira tarifore të Bashkisë së Churit është që institucioni parashkollor ta ketë një marrëveshje bashkëpunimi me Shërbimin Social (Soziale Dienste). Orët shtesë apo gjysmë ditët shtesë i paguajnë prindërit vetë.

Çfarë do të thotë edukimi i prindërve?

Prindërit, fëmijët e të cilëve marrin pjesë në programin „Deutsch für die Schule“, obligohen që gjatë vitit shkollor 2018/2019 të marrin pjesë në tetë kurse për edukimin e prindërve. Në këto kurse prindërit mësojnë si t' i ndihmojnë fëmijët e tyre gjatë mësimit të gjuhës gjermane dhe marrin informacione lidhur me sistemin shkollor dhe për tema tjera të dobishme. Oferta për edukimin e prindërve organizohet në atë mënyrë që edhe prindërit që punojnë dhe prindërit pa njohuri të gjuhës gjermane mund të marrin pjesë në të. Oferta për edukimin e prindërve është falas.

Drejtores e programit „Deutsch für die Schule“:

Bettina Joos Lopez

Kornplatz 12, 7000 Chur

Telefon 081 254 46 24

E-Mail deutschfuerdieschule@chur.ch

Adresa postare:

Deutsch für die Schule, Kornplatz 12, Postfach 810, 7001 Chur

www.integration-chur.ch